



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 20.11.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR VLERËSIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT

“PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 6 mbledhje, të zhvilluara në datat 5, 12, 13, 14, 19 dhe 20 nëntor 2018, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”. Shqyrtimi në parim i projektbuxhetit u zhvillua bazuar në nenet 78-81 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- Nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie. Ministri i Financave paraqiti prezantime të detajuara për projektbuxhetin në tërësi dhe për pjesët e veçanta të tij, si dhe dha informacionet përkatëse për pyetjet e deputetëve.

Relatorët e caktuar nga Komisioni për këtë projektligj, z. Anastas Angjeli dhe znj. Evis Kushi, paraqitën disa raporte, respektivisht për vlerësimin në parim të projektbuxhetit në tërësi dhe të pjesëve të veçanta të tij, duke dhënë edhe disa rekomandime për të ardhmen. Më pas, Komisioni vijoi me pyetjet e përgjigjet për projektligjin, si dhe me diskutimet.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik. Në një mbledhje të posaçme Komisioni shqyrtoi veprimtaritë në fushën e koncesioneve dhe të partneritetit publik privat, si dhe efektet e tyre në ekonomi. Shqyrtimi në parim i projektbuxhetit u koordinua me shqyrtimin në parim të projektligjeve të paketës fiskale, për shkak të efekteve financiare përkatëse.

Që prej vitit 2015, projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të viteve 2020 dhe 2021, për të siguruar përshpejtimin e ritmeve të rritjes ekonomike dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit mbështeten në:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2019-2021;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimin sa më shpejt drejt nivelit të mirëqenies së Bashkimit European. Ky dokument përcakton edhe drejtimet kryesore për realizimin e këtyre objektiveve, të cilat janë:

- Targetimi i një trajektoreje rënëse të borxhit publik;
- Mbajtja e një niveli investimesh publike mbi nivelin e defiçitit të përgjithshëm fiskal dhe mundësisht afër nivelit optimal prej 5 për qind të PBB;
- Harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve;
- Zbutja e defiçitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të rezervave valutore.

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni European, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po zhvillohet pozitivisht dhe me ritme të qëndrueshme, duke arritur një normë më të lartë rritjeje se mesatarja e Ballkanit Perëndimor. Edhe për vitet e ardhshme pritshmëritë për rritjen ekonomike janë pozitive. Progres i rëndësishëm është arritur në fushën e konsolidimit fiskal, që shprehet nëpërmjet reduktimit të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Në këtë rezultat kanë ndikuar përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave, si dhe mirëmenaxhimi i shpenzimeve publike, ku një ndër faktorët është reduktimi i pagesave të lidhura me energjinë, në reflektim të reformës në këtë sektor. Reformat strukturore vijnë progresin. Pritshmëritë janë që Shqipëria të rrisë elasticitetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë, duke forcuar disiplinën fiskale dhe sistemin financiar. Avancimi i procesit të integritetit do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe konvergencën e të ardhurave me rajonin. Gjithashtu, përfaqësuesit e FMN dhe Bankës Botërore kanë vlerësuar pozitivisht politikën monetare lehtësuese të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet vazhdimit të stimullit monetar, për të kontribuar në nxitjen e aktivitetit ekonomik dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2018, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

II. Opinioni i Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin.

Në datën 20 nëntor 2018, Komisioni për Ekonominë dhe Financat zhvilloi një seancë dëgjimore me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, për të marrë opinionin e institucionit që ai drejton për projektbuxhetin.

Gjatë analizës për politikën fiskale dhe ndikimin e saj në ekonomi, Guvernatori theksoi se ekonomia shqiptare ndodhet në një trajektore pozitive zhvillimi, e cila shprehet nëpërmjet përshejtit të ritmit të rritjes ekonomike, rritjes së punësimit dhe rënies së normës së papunësisë, si dhe përmirësimit të bilanceve financiare të familjeve, bizneseve dhe sektorit bankar. Treguesit kryesorë makroekonomikë janë përmirësuar. Premisat për rritjen ekonomike në të ardhmen mbeten pozitive, duke u mbështetur në burime të qëndrueshme e të diversifikuara në drejtim të kërkesës agregate, zhvillimit të sektorëve prodhues dhe përmirësimeve të pritshme në ambientin e jashtëm. Ky zhvillim i ekonomisë është mbështetur nga harmonizimi i politikës monetare me politikën fiskale. Projektbuxheti ruan tendencën e konsolidimit fiskal. Ai siguron mbështetje për zhvillimin afatgjatë të vendit, duke ruajtur një nivel të lartë të investimeve publike, qëndrueshmëri të sistemit tatimor, duke ulur koston e financimit me kapital të bizneseve dhe duke parashikuar vijimin e luftës kundër informalitetit në ekonomi.

Më pas, Guvernatori analizoi ndikimin e strategjisë së huamarrjes dhe të administrimit të borxhit publik në tregun financiar shqiptar. Ai theksoi se projektbuxheti parashikon një deficit buxhetor dhe borxh publik në rënie, si dhe një rënie të nivelit të borxhit të huaj, duke sjellë ulje të koston e financimit, minimizim të rrezikut të likuiditetit dhe luhatshmërisë së borxhit dhe duke zbatuar kështu një strategji financimi të arsyeshme. Gjithashtu, ai paraqiti disa rekomandime për strategjinë e huamarrjes gjatë vitit 2019, si dhe në periudhën afatmesme e afatgjatë.

Duke analizuar treguesit e qëndrueshmërisë së financave publike të vendit, Guvernatori theksoi se projektbuxheti respekton kërkesat e ligjit organik të buxhetit në drejtim të disiplinës fiskale, duke synuar rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike dhe forcimin e shëndetit afatgjatë të financave publike. Konsolidimi fiskal do të vijojë edhe në periudhën afatmesme. Gjithashtu, ai paraqiti disa rekomandime për menaxhimin e risqeve të mundshme gjatë zbatimit të buxhetit.

Në përfundim, Guvernatori paraqiti disa sugjerime mbi rritjen e efektivitetit dhe të qëndrueshmërisë së financave publike.


III. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 ekonomia e vendit vijoi ecurinë pozitive, në përputhje me parashikimet fillestare. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit, si rrjedhojë e shfrytëzimit më të plotë të kapaciteteve prodhuese, rritjes së punësimit, pagave dhe presioneve të brendshme inflacioniste. Këto zhvillime u mbështetën nga kushtet e favorshme financiare, si rrjedhojë e politikës monetare lehtësuese, flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte, si dhe rritjes së prodhimit të energjisë elektrike, si pasojë e situatës më të mirë hidrike të vitit aktual. Ambienti i huaj pati përmirësime dhe ndikoi pozitivisht.

Sipas statistikave zyrtare, rritja ekonomike arriti nivelin 4.4 për qind në 6-mujorin e parë. Për vitin 2018 rritja ekonomike vlerësohet të jetë 4.2 për qind, nga 3.9 për qind që ishte një vit më parë. Ky rezultat u mbështet nga rritja e kërkesës agregate, e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila u shpreh nëpërmjet rritjes së konsumit, investimeve private dhe eksporteve. Për 6-mujorin e parë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, konsumi u rrit me 2.7 për qind, ndërsa investimet me 2.8 për qind.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, kontributin kryesor në rritjen ekonomike e dhanë industria; tregtia; aktivitetet shkencore, profesionale e teknike; administrata publike e mbrojtja, arsimi e shëndetësia etj.

Që prej vitit 2013, ekonomia e vendit ka arritur një trajektore rritëse të qëndrueshme, si më poshtë:



Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, rritja ekonomike vijoi të jetë ndër më të lartat në rajon.

Politika monetare lehtësuese e Bankës së Shqipërisë ndikoi në nxitjen e aktivitetit ekonomik, rritjen e inflacionit dhe afrimin e tij më pranë objektivit, si dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Rritja e presioneve të brendshme inflacioniste u pasqyrua në rritjen e normës së inflacionit, e cila për periudhën 6-mujore arriti nivelin 2.1 për qind, ndërkohë që në muajt korrik e gusht ishte 2.3 për qind dhe 2.2 për qind. Parashkimet janë që inflacioni të kthehet në objektiv brenda vitit 2020, duke u mbështetur nga zgjerimi i vazhdueshëm i kërkesës agregate, e cila do të mundësojë rritjen e punësimit, të pagave e të marzheve të fitimit, në linjë me normat e tyre historike. Sistemi bankar vijoi të ketë nivele të kënaqshme të kapitalizimit dhe likuiditetit. Rritja e kërkesës agregate ndihmoi në përmirësimin e balanceve financiare të bizneseve dhe reduktimin e kredive me probleme, të cilat në 3-mujorin e tretë të këtij viti arritën nivelin 12.9 për qind, që është niveli më i ulët i viteve të fundit. Reduktimi i kredive me probleme i hap rrugën rritjes së kontributit të sistemit bankar në ekonomi dhe nxitjes së mëtejshme të një kreditimi të shëndetshëm.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik u reflektua në tregun e punës. Për 6-mujorin e parë punësimi u rrit me 3.3 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Norma e papunësisë, për popullsinë e moshës 15-64 vjeç, në 3-mujorin e dytë 2018, arriti nivelin 12.9 për qind, duke u reduktuar me 1.4 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Për periudhën 8-mujore eksportet u rritën me 16.1 për qind, ndërsa importet u rritën me 4 për qind, duke ndikuar në përmirësimin e bilancit tregtar. Defiçiti i llogarisë korrente u përmirësua, si rezultat i përmirësimit të defiçitit tregtar, zgjerimit të sufiçitit në shërbime dhe në të ardhura dytësore. Kontribut pozitiv dhanë shërbimet e lidhura me sektorin e turizmit. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë u përmirësua dhe ndikimin kryesor e dha rritja e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte me 28 për qind për periudhën 6-mujore, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të

mëparshëm. Në tërësi, bilanci i pagesave për 6-mujorin u përmirësua me 15 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2018 priten të jenë 458.2 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2017, ato janë rritur me 27.8 miliardë lekë ose 6.5 pikë përqindje. Kjo rritje e performancës në mbledhjen e të ardhurave është rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe përmirësimit në administrimin e taksave, ndërkohë që kursi i këmbimit ka ndikuar negativisht në të ardhurat nga importi.

IV. Vlerësimi i Komisionit për projektbuxhetin.

Komisioni vlerëson se projektbuxheti i vitit 2019, ka disa karakteristika, si më poshtë:

1. Vijimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Gjatë vitit 2019 ekonomia e vendit do të vijojë tendencën në rritje dhe kjo tendencë do të shtrihet edhe në periudhën afatmesme. Në vitin 2019 rritja ekonomike vlerësohet të jetë 4.3 për qind, në vitin 2020 pritet 4.4 për qind, ndërsa në vitin 2021 pritet të jetë 4.5 për qind. Kjo rritje e ekonomisë do të vijojë të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, nëpërmjet rritjes së konsumit privat dhe investimeve. Kërkesa e huaj do të sjellë një efekt të vogël pozitiv. Konsumi total pritet të rritet në terma realë me 3.1 për qind në vit, ndërsa investimet totale pritet të rriten me mbi 5 për qind në vit.

Konsumi privat do të rritet si rezultat i pritshmërive për përmirësimin e besimit të konsumatorit, si dhe përmirësimet në tregun e punës. Rritja ekonomike do të ndikojë në rritjen graduale të pagave, të cilat do të sjellin rritje të të ardhurave reale të disponueshme të individëve, si dhe nxitje të konsumatorëve për konsum dhe për kredimarrje më të lartë. Edhe lehtësimi i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar pritet të ndikojë në rritjen e të ardhurave të individëve.

Rritja e investimeve pritet të nxitet nga përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, përsheptimi i aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i besimit të biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme dhe afatgjatë. Në nxitjen e investimeve private në periudhën afatmesme pritet të ndikojnë edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies.


2. Thellimi i konsolidimit fiskal.

Konsolidimi fiskal është objektivi kryesor i projektbuxhetit. Ky objektivi pasqyrohet në reduktimin e defiçitit buxhetor dhe të borxhit publik.

Defiçiti buxhetor për vitin 2019 parashikohet në nivelin 1.9 për qind të PBB, nga 2 për qind e PBB që pritet të realizohet për vitin 2018. Gjatë periudhës afatmesme defiçiti buxhetor parashikohet të reduktohet më tej, duke arritur nivelin 1.2 për qind të PBB në vitin 2021.

- Bilanci primar për të katërtin vit radhazi është pozitiv. Për vitin 2019 ai parashikohet të jetë me sufiçit në nivelin 0.5 për qind e PBB, duke u rritur më tej në vitet e ardhshme.
- Bilanci korrent fiskal është parashikuar me sufiçit, në nivelin mbi 3 për qind të PBB për periudhën 2019-2021. Kjo tregon që të ardhurat e buxhetit financojnë shpenzimet korrente dhe një pjesë të shpenzimeve kapitale. Investimet parashikohen në nivelin 5 për qind e PBB. Nga këto, 3 përqind e PBB financohen nga të ardhurat e buxhetit dhe pjesa tjetër nga huatë. Ky zbatim i rregullit të artë të buxhetit tregon përgjegjshmëri në menaxhimin e financave publike.

Borxhi publik parashikohet me tendencë në ulje nga viti në vit gjatë gjithë periudhës afatmesme, duke zbatuar kështu një ndër rregullat kryesorë fiskalë të buxhetit dhe një ndër objektivat kryesorë strategjikë të ekonomisë. Stoku i borxhit publik për vitin 2019 parashikohet të arrijë nivelin 65.5 për qind të PBB, nga 69.1 për qind e PBB në vitin 2018. Ky trend në rënie parashikohet edhe për vitet e ardhshme, duke arritur nivelin 59.9 për qind të PBB në vitin 2021. Ecuria ndër vite dhe parashikimet për borxhin publik janë si më poshtë:



Gjatë viteve 2017-2018 kostoja e borxhit është reduktuar. Për vitin 2019 shpenzimet për interesa të borxhit parashikohen pothuajse në nivele të krahasueshme me vitin 2018, duke reflektuar nivelin e ulët të normave aktuale të interesit dhe efektin që krijon procesi i blerjes mbrapsht të eurobondit ekzistues.

3. Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 parashikohen të rriten me 21.8 miliardë lekë ose 5 pikë përqindje në krahasim me aktin normativ të vitit 2018. Programimi i të ardhurave është mbështetur në objektivin për konsolidimin fiskal, rritjen ekonomike, politikat fiskale, si dhe politikat për përmirësimin e mëtejshëm të administrimit fiskal dhe të reduktimit të informalitetit në ekonomi. Ndikim në të ardhurat kanë edhe kursi i këmbimit dhe ndryshimi i çmimeve.

Politikat fiskale të parashikuara për vitin 2018 synojnë:

- Uljen e barrës tatimore për grupe të caktuara individësh, si të punësuarit me nivel të mesëm pagash, investitorët e kapitalit;
- Dhënien e incentivave dhe stimujve tatimorë për industri dhe sektorë të caktuar si bujqësia, fasoni, farmaceutika etj;
- Stimulimin e politikave në transport, në funksion të mbrojtjes së mjedisit;
- Rregullime të barrës fiskale në fushën e mallrave të akcizës;
- Mbrojtjen e bazës së tatimit dhe interesit financiar të vendit tonë, nëpërmjet të drejtës së taksimit në Shqipëri të fitimeve kapitale që rrjedhin nga pasuri, asete dhe të drejta në territorin shqiptar;

- Mbylljen e mundësive për përfitimin e stimujve fiskalë, nëpërmjet keqpërdorimit të legjislacionit fiskal;
- Implementimin në legjislacionin tatimor shqiptar të Direktivës së BE në lidhje me transparencën fiskale dhe rregullat që duhen zbatuar për shmangien e qëllimshme të tatimeve.

4. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 parashikohen në nivelin 519.4 miliardë lekë ose 29.6 për qind e PBB. Në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit të mëparshëm, ato do të rriten me mbi 5.9 për qind. Në krahasim me aktin normativ të buxhetit 2018, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit parashikohen të rriten me 22.3 miliardë lekë ose 4 pikë përqindje.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2019 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë: arsimin, shëndetësinë, bujqësinë dhe infrastrukturën, duke stimuluar rritjen ekonomike dhe duke gjeneruar rritjen e punësimit. Gjithashtu, shpenzimet buxhetore mbështesin një sërë reformash në ekonomi, si:

- Rritja me 7 për qind e pagave në sektorët e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe sistemit penitenciar; si dhe rritja me 20 për qind e pagave të punonjësve të përfaqësive diplomatike. Për të rritur performancën në arsimin parashkollor, fondi i pagave për edukatorët në arsimin parashkollor do të rritet me 9.1 për qind në krahasim me vitin 2018 dhe ndarja e fondeve midis bashkive do të bazohet në një formulë që mbështetet kryesisht tek numri i nxënësve përfitues.
- Planifikimi i plotë i kostos së sistemit të drejtësisë, për të realizuar akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë, si dhe akomodimin e institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme;
- Rritja e mundshme e normave të interesit, nga 1 pikë përqindje në 2 pikë përqindje;
- Mbështetja me prioritet e skemës së fermerëve;
- Mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar;
- Mirëmbajtja e shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
- Reduktimi i shpenzimeve për subvencione në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për shkak të përmirësimit të performancës së tij, si dhe mbështetja me subvencione e hekurudhave dhe nxitjes së punësimit.

Shpenzimet buxhetore mbështesin edhe investimet publike, të cilat detajohen më poshtë.

5. Rritja e investimeve publike mbetet prioritet i projektbuxhetit.

Investimet publike në vitin 2019 parashikohen në nivelin 88.8 miliardë lekë ose 5.1 për qind e PBB. Këtu përfshihet edhe mbështetja për sektorin e energjisë me 3 miliardë lekë. Në krahasim me aktin normativ 2018 ato parashikohen të rriten me 2.1 miliardë lekë ose 2 pikë përqindje. Planifikimi i investimeve mbështetet në prioritetet e Programit të Qeverisë dhe ato të integritit evropian, financimin e projekteve në vazhdim, si dhe mbështetjen me kosto lokale e TVSH të projekteve me financim të huaj.

6. Projektbuxheti parashikon vijimin e reformave në sektorët kyç të ekonomisë.

Gjatë vitit 2019 do të vijojë zbatimi i reformave të nisura në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, si dhe i reformave ndërsektoriale në administratën publike dhe menaxhimin e financave publike. Disa nga reformat më të rëndësishme që do të financohen nga projektbuxheti 2019 janë:

Reforma në arsim.

Shpenzimet për sektorin e arsimit, për vitin 2019, përbëjnë rreth 42 miliardë lekë. Për periudhën afatmesme 2019-2021 këto shpenzime janë parashikuar në një nivel konstant prej 3 për qind të PBB. Disa nga reformat më të rëndësishme që do të financohen me përparësi nga projektbuxheti janë: rritja e pagave të mësuesve në vitin 2019, ofrimi i teksteve shkollore falas për një pjesë të nxënësve të arsimit parauniversitar, financimi i shpenzimeve të transportit për nxënësit me vendbanim të largët nga shkolla, trajtimi me kuotë ushqimore i nxënësve të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, ndërtimi dhe rikonstruksioni i në një sërë objektsh shkollorë etj.

Reforma në shëndetësi.

Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë për vitin 2019 parashikohen në nivelin 50.5 miliardë lekë. Për periudhën 2019-2021 këto shpenzime parashikohen të jenë mesatarisht 2.9 për qind e PBB. Projektbuxheti do të financojë me përparësi rritjen e pagave për mjekët dhe infermierët, reduktimin e numrit të pacientëve të shtruar me të njëjtën diagnozë të rishtruar brenda 72 orësh, reduktimin e kohës së pritjes për ekzaminime të rëndësishme, reduktimin e indeksit të vdekshmërisë foshnjore, garantimin e mbulimit me vaksina, rikonstruksionin e qendrave shëndetësore, vendosjen e një tavani prej 10.5 miliardë lekësh për financimin e skemës së rimbursimit të barnave.

Reforma në bujqësi.

Shpenzimet për sektorin e bujqësisë për periudhën 2019-2021 janë parashikuar në nivelin 0.6 për qind të PBB. Disa nga reformat kryesore që do të financohen në këtë sektor janë rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore që i ofrohet shërbimi i ujitjes, rritja e numrit të fermerëve të mbështetur nga skemat kombëtare, rritja e sipërfaqeve të mbjella me drufrutorë e perime nga sera etj.

Reforma në infrastrukturë.

Shpenzimet për sektorin e infrastrukturës parashikohen rreth 2.8 për qind e PBB për vitet 2019-2021. Përparësi në financimin e infrastrukturës do të kenë:

- Përfundimi i akseve rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit; Thumanë-Vorë-Kashar; Milot-Balldren; Orikum-Dukat, brenda vitit 2021 me projektin “1 Miliardë”;
- Vazhdimi i financimit për akset rrugore Kardhiq-Delvinë; Fushë Krujë-Milot-Morinë; Qafëthanë-Lin-Pogradec; By Pass Shkodër; By Pass Tepelenë; një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës;
- Rritja e sigurisë rrugore dhe ulja e numrit të aksidenteve;
- Fondi i Mirëmbajtjes së Rrugëve 2019-2021 parashikohet të jetë më i larti i 25 viteve të fundit, mesatarisht rreth 3.7 miliardë lekë;

- Vënia në funksion e aeroporteve të Vlorës dhe Kukësit nëpërmjet skemave të Partneritetit Publik Privat;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime për zonën bregdetare brenda vitit 2021;
- Në vitin 2020 parashikohet të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38 %, kundrejt vitit 2009;
- Në vitin 2021 synohet të riciklohet rreth 20 % e totalit të mbetjeve të prodhuara, nga 0.05% që parashikohet në vitin 2018.

7. Thellimi i decentralizimit fiskal dhe rritja e autonomisë financiare të qeverisjes vendore.

Viti 2019 është viti i katërt i zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal, e cila do të sjellë rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetqeverisjes vendore dhe konsolidimin e financave publike vendore. Buxheti i pushtetit vendor parashikohet të jetë 51 miliardë lekë, me një rritje prej 5 miliardë lekësh ose 11 pikë përqindje në krahasim me vitin 2018, të cilat do të përdoren për rritjen e investimeve publike dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Kjo rritje është në vijim të rezultateve mjaft pozitive të arritura gjatë vitit 2018 dhe do të realizohet nga rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore me 3.9 miliardë lekë, si dhe rritja e transfertës së pakushtëzuar të buxhetit të shtetit me 0.9 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave vendore do të vijë nga ndarja më e drejtë dhe transparente e financave të vetqeverisjes vendore, përmirësimi i skemës së financimit të funksioneve të veta dhe rritja e burimeve të financimit të njësive të vetqeverisjes vendore. Ndikim pozitiv në të ardhurat do të kenë edhe ndryshimet që po zbatohen në taksën e pronës, nëpërmjet taksës mbi ndërtesat dhe ngritjes së kadastrës fiskale.

Në përfundim, Komisioni dha disa rekomandime mbi politikën kryesore që duhet të vijojnë të ndiqen gjatë vitit 2019 dhe periudhës afatmesme për të arritur objektivat e parashikuara në projektbuxhet; siç janë nxitja e përdorimit optimal të faktorëve të rritjes ekonomike, thellimi i konsolidimit fiskal, vijimi i reformave strukturore; përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave; disiplinimi dhe rritja e cilësisë së shpenzimeve publike; rritja e investimeve publike, harmonizimi i politikës konsoliduese fiskale me politikën lehtësuese monetare, si dhe monitorimi i risqeve të mundshme fiskale.

V. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të tjera.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat u njoh me raportet në parim të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit për projektbuxhetin. Në këto raporte pasqyrohet vlerësimi pro i mazhorancës dhe vlerësimi kundër i opozitës për projektbuxhetin, si dhe jepen argumentet përkatëse. Në disa raporte paraqiten propozime për ndryshime në buxhetin e institucioneve të varësisë. Komisioni për Ekonominë dhe Financat do t'i shqyrtojë të gjitha propozimet e komisioneve të tjera gjatë fazës së shqyrtimit nën nën të projektbuxhetit, për të arritur plotësimin e kërkesave brenda mundësive që ofron projektbuxheti.

VI. Përfundim.

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018” me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

RELATORËT

Anastas ANGJELI

Evis KUSHI

KRYETARI

Erion BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 27.11.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR VLERËSIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT
“PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 21, 23 dhe 27 nëntor 2018, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e shqyrtimit të projektbuxhetit nen për nen u mbështet në nenet 32-39, 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Shqyrtimi nen për nen i projektbuxhetit u zhvillua pas miratimit në parim të tij, në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Ai mori në konsideratë edhe projektligjet e paketës fiskale dhe ndryshimet përkatëse, të miratuara në Komision, për shkak të efekteve financiare përkatëse.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe drejtues e përfaqësues të stafit të kësaj ministrie, të cilët dhanë sqarimet përkatëse për pyetjet e deputetëve.

Komisioni zhvilloi disa seanca dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara në projektbuxhet, respektivisht me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; si dhe Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për t’u njohur më në detaj me investimet e parashikuara në projektbuxhet në këta sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë paraqiti një informacion të detajuar për projektet specifike të parashikuara për vitin 2019. Ai theksoi se në projektet e infrastrukturës rrugore është vendosur si përparësi përfundimi brenda mandatit aktual 4-vjeçar i projekteve në vazhdim dhe moshapja e projekteve të reja rrugore, që janë të pamundura për t’u financuar. Pasi bëri një përshkrim të detajuar të kontratave të koncesioneve dhe partneritetit publik privat, Ministri theksoi se u është dhënë përparësi përfundimit të të gjitha veprave të nisura në vitet e mëparshme, por edhe kontratave të reja që janë veprat kryesore dhe më të rëndësishme të transportit rrugor kombëtar, të cilat janë pjesë e rrjetit rrugor europian. Gjithashtu, projektbuxheti financon edhe sektorë të tjerë, si mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, investimet në sektorin e energjisë, transportin hekurudhor, ujësjellës-kanalizimet, zonat me përparësi turizmin, trajtimin e mbetjeve etj. Përpjekje po bëhen edhe për mbështetjen e zhvillimit të industrisë përpunuese.

Ministrja e Arsimit vuri theksin në thellimin e reformave në këtë sektor, rritjen e pagës për mësuesit, shtimin e mësuesve ndihmës, sigurimin e transportit për nxënësit dhe mësuesit, mbylljen e klasave kolektive, sigurimin e teksteve falas për klasën e 5-të, si dhe mbështetjen e shtresave në nevojë. Një prioritet i rëndësishëm është investimi në objektet e reja arsimore.

Ministrja e Shëndetësisë theksoi se gjatë vitit 2019 do t'i kushtohet vëmendje e veçantë financimit të të dy sektorëve, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Pagesa e ndihmës ekonomike do të dyfishohet dhe skema përkatëse do të shtrihet në të gjithë vendin. Do të ketë dyfishim të investimeve për përmirësimin e infrastrukturës në spitalet dhe qendrat shëndetësore në të gjithë vendin. Më pas, ajo u ndal në kontratat e partneritetit publik-privat për kontrollin mjekësor bazë, shërbimin e laboratorëve etj dhe rolin e tyre në parandalimin e sëmundjeve apo kryerjen e analizave laboratorike.

Për t'u njohur më në thellësi me projektbuxhetin për Radio Televizionin Shqiptar, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore pranë këtij institucioni të rëndësishëm për ruajtjen dhe pasqyrimin e identitetit të kulturës shqiptare, si dhe mbështetjen e krijimtarisë letrare e artistike në vend. Komisioni u njoh me nevojat buxhetore të këtij institucioni dhe kërkesat për rritjen e mbështetjes buxhetore për projektet, veçanërisht për futjen e teknologjive të reja në prodhim dhe transmetim. Pasi analizoi këto kërkesa, Komisioni miratoi një shtesë fondesh buxhetore për mbështetjen e këtij institucioni, në përputhje edhe me mundësitë që ofron buxheti i shtetit, siç përcaktohet në pjesën e mëposhtme, më të detajuar, të këtij raporti.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit për vlerësimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019". Në këto raporte pasqyrohet se në secilin komision projektbuxheti është miratuar, nen për nen dhe në tërësi. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2019 për ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre, duke dhënë edhe argumentet mbështetëse.

Gjithashtu, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat janë paraqitur disa propozime të argumentuara, për ndryshime në projektbuxhet, nga Byroja e Kuvendit, Kontrolli i Lartë i Shtetit etj.

Të gjitha propozimet e paraqitura u analizuan nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si dhe u konsultuan me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, për të parë mundësinë e mbulimit të tyre me burimet e nevojshme buxhetore.

Në përfundim të këtij procesi, si dhe duke analizuar burimet e mundshme për të përballuar shtesën e shpenzimeve buxhetore, Komisioni miratoi një pjesë të propozimeve. Për propozimet e paplotësuara, Komisioni rekomandon përballimin e nevojave të domosdoshme nga fondi i parashikuar në projektbuxhet, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në dispozicion.

Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi, duke propozuar disa shtesa e ndryshime në projektligj, si më poshtë:

A) Në nenet e projektligjit bëhen këto ndryshime:

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Buxheti vendor për vitin 2019 është:

Të ardhurat	51 286	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	17 632	milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	7 443	milionë lekë;
- Të ardhura të tjera	26 211	milionë lekë;
Shpenzimet	51 286	milionë lekë.”.

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	388 545	milionë lekë;
- Fondi për rritjen e pagave	2 000	milionë lekë;
- Fondi rezervë	1 400	milionë lekë;
- Fondi rezerve i sistemit të drejtësisë	1 400	milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 300	milionë lekë”.”.

Në **nenin 11**, fjalia e parë, numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë bëhet “82 120”.

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Fondi rezervë i buxhetit prej 1 400 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë, përdoret:

- deri në 1 miliardë lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për financimin e pagave të reja të magjistratëve;
- deri në 400 milionë lekë, nga Këshilli i Ministrave për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.”.

Në **nenin 19**, rreshti i tretë, viti 2018 bëhet viti 2019.

B) Në tabelat dhe anekset bashkëlidhur projektligjit bëhen këto ndryshime:

Së pari, në mbështetje të reformës në drejtësi dhe procesit të vettingut, bëhen disa ndryshime në institucionet e mëposhtme:

- 1. Prokurorisë së Përgjithshme** i shtohen 15 punonjës.
- 2. Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive** i shtohen shpenzimet korrente me 4 milionë lekë.
- 3. Shkollës së Magjistraturës** i shtohen shpenzimet kapitale me 5 milionë lekë.
- 4. Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** i shtohen 9 punonjës.

5. **Komisionerit për mbrojtjen e të Dhënave Personale** i shtohen shpenzimet kapitale me 15 milionë lekë.

Së dyti, bëhen disa ndryshime në disa institucione kryesore dhe të pavarura, si më poshtë:

1. **Kuvendit i** shtohen shpenzimet me 176 milionë lekë, për një sërë veprimtarish, të lidhura kryesisht me festimin e 100 vjetorit të themelimit të institucionit, të detajuara sipas tabelës bashkëlidhur.
2. **Kontrollit të Lartë të Shtetit** i shtohen 5 punonjës dhe 10 milionë lekë shpenzime personeli, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm dhe konsolidimit të auditimit të performancës, auditimit financiar dhe auditimit IT.
3. **Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së** i shtohen shpenzimet kapitale me 200 milionë lekë, për rinovimin e teknologjisë së institucionit.
4. **Komisionit Qendor të Zgjedhjeve** i shtohen shpenzimet kapitale me 25 milionë lekë;
5. **Agjencisë Telegrafike Shqiptare** i shtohen shpenzimet kapitale me 3 milionë lekë.
6. **Autoritetit të Konkurrencës** i shtohen shpenzimet kapitale me 2.5 milionë lekë.
7. **Në Shërbimin Informativ Shtetëror** shtohen 85 punonjës, si dhe rialokohen shpenzimet, duke pakësuar shpenzimet për mallra dhe shërbime në shumën 58 milionë lekë dhe duke shtuar shpenzimet e personelit me të njëjtën vlerë.
8. **Akademisë së Shkencave** i shtohen shpenzimet kapitale me 1 milionë lekë.
9. **Institutit të Statistikave** i shtohen 10 punonjës.

Së treti, bëhen disa ndryshime në ministrinë si më poshtë:

1. **Në Ministrinë e Drejtësisë** parashikohet si zë i veçantë buxheti për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
2. **Në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**, rialokohen shpenzimet korrente midis programeve, duke pakësuar me 100 milionë lekë programin “Zhvillimi rural 04250” dhe duke shtuar me të njëjtën vlerë programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”.
3. **Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** bëhen këto ndryshime:
 - Rialokohen fondet në transfertën për FSDKSH, duke pakësuar me 1 miliardë lekë shpenzimet në programin e kujdesit parësor dhe duke shtuar me të njëjtën vlerë shpenzimet në programin e kujdesit dytësor.
 - Shtohen me 35 milionë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat 25 milionë lekë për testimin e fëmijëve me sindromën down dhe 10 milionë lekë për shërbimin e urgjencës mjekësore në disa bashki.

4. **Në Ministrinë e Mbrojtjes** shtohen shpenzimet kapitale me 700 milionë lekë, në kuadër të anëtarësimit në NATO. Këto fonde do të përdoren në destinacionet si më poshtë:
 - 200 milionë lekë për akomodimin e rritjes së pagave të personelit;
 - 100 milionë lekë për Spitalin e Traumës;
 - 400 milionë lekë për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (ndërtimin e urave Bailey), si dhe Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit (integrimin e sistemit të radarëve për mbikqyrjen e hapësirës detare).
5. **Në programin** “Shërbimi për Disaporën” shtohen shpenzimet me 100 milionë lekë, për të siguruar përputhjen me aktet ligjore përkatëse. Shpenzimet për këtë program detajohen midis 3 institucioneve të diasporës, sipas tabelës bashkëlidhur.
6. **Në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme** rialokohen shpenzimet korrente midis programeve, duke shtuar 8 milionë lekë në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” dhe 8 milionë lekë në programin “Mbështetja institucionale për procesin e integritit”, si dhe duke pakësuar me 16 milionë lekë programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.
7. **Në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** pakësohen 26 punonjës, të cilët i kalojnë Bashkisë Tiranë; si dhe pakësohen me 32 milionë lekë shpenzimet korrente në programin “Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë”, të cilat i kalojnë transfertës së pakushtëzuar sektoriale.

Së katërti, pushtetit vendor i shtohen 105 milionë lekë shpenzime korrente në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, e detajuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kolonës: “Shtesë nga Kuvendi, “Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme 2019” sipas tabelës 3 bashkëlidhur (për bashkitë; Divjakë, Lushnjë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Patos dhe Rrogozhinë me nga 15 milionë lekë secila).

Së pesti, bëhen disa saktësime në tabelat dhe anekset e buxhetit, si më poshtë:

- **Aneksi 3** i projektligjit “Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale” ndryshohet sipas variantit bashkëlidhur këtij raporti.
- **Në tabelën 3** të projektligjit shtohet një kolonë me këtë përmbajtje: Klubet shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti” me shumën 32 milionë lekë në rreshtin e Bashkisë Tiranë.
- **Në aneksin nr.4** të projektligjit shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Klubet sportive shumësportëshe, “Partizani” dhe “Studenti”.

Në transfertën e vitit 2019, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për personelin dhe shpenzimet operative të klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në bashkinë Tiranë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.”.

- **Në tabelën 4:** “Treguesit fiskalë” shtohen: 105 milionë lekë tek transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe 32 milionë lekë në totalin e transfertës së pakushtëzuar sektoriale, ndryshim i cili reflektohet në totalin e transfertave të buxhetit të shtetit për pushtetin vendor dhe totalin e shpenzimeve të buxhetit vendor.

Së gjashti, burimet për mbulimin e shtesës së shpenzimeve prej 1381.5 miliardë lekësh, si më lart, përballohen nga pakësimet e shpenzimeve në institucionet e mëposhtme:

Burimet	(Në milionë lekë)
FZHR	400
Ministria e Brendshme	150
Ministria e Financave	131
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	374.2
Ministria e Bujqësisë	50
Drejtoria e Burgjeve	50
Fondi rezervë për reformën në drejtësi	100
Fondi rezervë	100
Ujësjellësi	26.3
Totali	1381.5

Ndryshimet e mësipërme të pasqyrohen në tabelat dhe nenet respektive të projektligjit.

Sugjerime të Komisionit.

Së pari, pas hyrjes në fuqi të ligjit, Ministria e Financave duhet të fillojë menjëherë detajimin e buxhetit të vitit 2019, në mënyrë që të mos krijohen vonesa në fillimin e zbatimit të tij nga institucionet buxhetore.

Së dyti, realizimi periodik i detyrimeve buxhetore për të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor dhe borxhin publik është shumë rëndësishëm për të arritur objektivat vjetore e afatmesme në drejtim të konsolidimit fiskal dhe rritjes ekonomike të vendit.

Së treti, menaxhimi aktiv i detyrimeve të borxhit është një detyrim në vijimësi, për të optimizuar risqet e mundshme të portofolit.

Së katërti, Ministria e Financave duhet të vijojë e thellojë punën për të konfirmuar një standard të ri profesional, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për kalkulimin dhe llogaritjen e borxhit publik, duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet që janë bërë nga KLSH.

Së pesti, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet hartimit dhe zbatimit, në përputhje me detyrimet ligjore, të kontratave të koncesioneve dhe partneritetit publik privat, për të shmangur risqet e mundshme për buxhetin dhe qytetarët.

Së gjashti, lidhur me kërkesën për rritjen e numrit të punonjësve dhe shpenzimeve të personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Komisioni mbështeti propozimin e Ministrit të Financave për zgjidhjen e saj nëpërmjet rialokimit të fondeve të Ministrisë së Drejtësisë.

Së shtati, për të mbështetur bashkitë që ndodhen pranë zonës bregdetare, të cilat kanë fluks turistik në periudhën e verës, edhe pse sigurojnë të ardhura më të mëdha, Komisioni sugjeron që Ministria e Financave të bashkëpunojë me USAID-in për të rishikuar formulën e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të buxhetit të shtetit për pushtetin vendor. Formula duhet të krijojë mundësinë për një mbështetje më të madhe buxhetore për këto bashki. Ministria e Financave duhet të informojë Komisionin për këtë çështje brenda muajit mars 2019.

Së teti, për të zgjidhur disa problematika në pagesën e aftësisë së kufizuar, Komisioni sugjeron që strukturat përkatëse ekzekutive të rishikojnë aktet ligjore e nënligjore, me qëllim që kjo shtresë sociale të sigurojë përfitimet e nevojshme nga buxheti i shtetit. Informacioni për këtë çështje duhet të dërgohet pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financave brenda muajit mars 2019.

Përfundim.

Komisioni e miratoi, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” me votat pro të shumicës së deputetëve të pranishëm në mbledhje, me ndryshimet e pasqyruara më lart. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

RELATORËT

Anastas ANGJELI

Evis KUSHI

KRYETARI

Erion BRAÇE

ANEKSI 3

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.
3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6. Ministrin e Kulturës	anëtar;
7. Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:
 - a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;
 - b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;
5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.
7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.
9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
3. Subjektet aplikuese për fondet e programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Autoriteti kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit që nga shpallja e thirrjes deri në aprovimin për financim, si dhe raportimin e autoriteteve kontraktuese do të miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

KUVENDI

TABELA PER SHITESAT MBI PROJEKTLIGJIN "PER BUXHETIN E VITIT 2019

000/ekë

Gr	Tit	Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Kap	Emer Kapitulli	600 Pagat	601 Kontrib.e Sigurimeve Shoqerore	602 Mallra dhe Sherbime	603 Subvecinet	604 Transferr.Korrekte Brendshme	605 Transfer.Korrente te Huaja	606 a per Buxhetet Familiare dhe Individet	230 Shpenzime Kapitale te Patrupezuar	231 Shpenzime Kapitale te Trupezuara	Totali
2	1110	Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	10,128	0	0	0	0	0	0	0	132,000	142,128
2	1110		2	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		3	Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		4	TVSH, Detyrim doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		5	Nga te ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1120	Veprimtaria Ligjvënese	1	Çelje nga buxheti	0	0	33,500	0	0	0	0	0	0	33,500
2	1120		2	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		3	Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		4	TVSH, Detyrim doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		5	Nga te ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2		Kuvendi			10,128	0	33,500	0	0	0	0	0	132,000	175,628

Institucionet e Diaspores

(ne milione leke)

Emertimi i institucioneve	Shpenzime personeli	Shpenzime operative 602	Shpenzime kapitale	Totali
Agjencia Kombetare e Diaspores	0	55		55
Fondi Shqiptar per Zhvillimin e Diaspores			15	15
Qendra e Botimeve per Diasporen	4	16	10	30
Totali	4	71	25	100